

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjyqtaret Shqipe Qerimi, kryetare, Rasim Rasimi dhe Gani Zabeli anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.R. nga komuna e Vushtrisë, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. U.G., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtrri P.nr.23/2016 të datës 29.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit I.R., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- dega në Vushtrri, P.nr.23/2016 i datës 29.11.2016, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtrri, me aktgjykimin P.nr.23/2016 të datës 29.11.2016, të akuzuarin I.R., e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPK-së, për të cilën vepër i ka shqiptuar dënimin dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 2 (dy) viteve, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Në bazë të nenit 60 të KPK i ka shqiptuar dënimin plotësues, i merret pushka automatike AK-47, model M-70-AB2, e kalibrit 7.62 x39 mm me nr. serik 3100380 dhe 1809.

Është obliguar i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 40 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar: mbrojtësi i të akuzuarit av. U.G., për shkak të shkeljes së Ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarin ta lirojë nga akuza.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/II.nr.101/17 të dt. 30.01.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPPK dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë gjeti se :

Ankesa është e pabazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP-së, dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të Ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, në ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar drejtë sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike. Nga provat e administruara, nuk është vërtetuar se i mbrojturi i im e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata e ka bazuar vendimin e vet në të vetmen provë deklaratorë të pandehurit të dhënë në polici. I mbrojturi i im e ka pranuar që në ditën e parë para kësaj gjykate se armën e ka dorëzuar te policët, mirëpo ajo armë nuk ka qenë arma e tij. Nga deklaratat e dëshmitarëve u vërtetua se arma ka qenë e babait të ndjerë të akuzuarit.

Gjykata e Apelit gjen se këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë. Sipas shkresave të çështjes dhe gjendjes faktike të vërtetuar nga Gjykata e shkallës së parë del se edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejtë pretendohet në ankesën e të akuzuarit. Gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin gjyqësorë gjendjen faktike e ka vërtetuar drejt pas vlerësimit detal të provave të administruara, me dëgjimin e dëshmitarëve: R.Z., pastaj me dëshminë e dëshmitarit policit të stacionit policor në Vushtrri i cili ka deklaruar se me rastin e intervistimit të pandehurit i njëjti e ka pranuar veprën penale me të cilën ngarkohet, dëshmitarëve të tjerë dhe provave materiale me të cilat është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë se i akuzuari e ka kryer veprën penale, është i pakontestueshëm fakti se policët F.Sh. dhe J.T. ditën kritike me 28.05 2009 kanë përpiluar raportet policore lidhur me atë se ditën kritike është dorëzuar një armë automatike AK-47 me të dhëna si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si dhe një plumb. Është po ashtu i pakontestueshëm fakti se ditën kritike i pandehuri I.R. e ka dorëzuar pushkën automatike AK-47. Nuk është kontestues fakti se te i akuzuari është gjetur arma i cili personalisht ia ka dorëzuar patrullës së policisë.

Se i akuzuari I.R. ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, vërtetohet nga dëshmia e dorëzimit të armës automatike, patrullës së policisë së Kosovës

me të cilën nga ekzaminimet kriminalistike vërtetohen se është shtëne me të, po ashtu nga vetë deklaratat e të pandehurit të dhënë gjatë intervestimit në polici dhe pjesërisht nga vetë deklarimi i tij në shqyrtimin gjyqësorë po ashtu nga raportet e policeve hetues të stacionit policorë në Vushtrri dhe nga deklarata e dëshmitares R.Z. dhe dëshmitareve vëllezërve të tije dhe djalit të tije V.R., B.R. dhe H.R. të cilët deklarojnë se pushkën automatike ua ka dorëzuar ditën kritike me 28.25.2009 patrullës së policisë vetë I.R..

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin lidhur me sanksionin penal, në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit nuk arsyetohet vendimi mbi dënimin me arsyetimin se dënimi është jo i drejtë, megjithatë Gjykata e Apelit e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së shqiptimit të dënimit ka marrë për bazë për të akuzuarit se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, se seancën gjyqësore e ka përcjell me vëmendje të shtuar, si dhe ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit, se është i gjendjes së mesme ekonomike, se është prind i 6 fëmijëve, kohen e kaluar nga kryerja e veprës penale, kurse rrethana rënduese ka gjetur se për këtë vepër parashihet një dënim i lartë , dhe shtënja me armë paraqet rrezikshmëri të lartë.

Sipas vlerësimit të kolegjit të gjykatës së Apelit dënimi që iu është shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet ti shërbejë preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryesi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikojë në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, konsideron se me dënimin me kushte të shqiptuar si në dispozitiv do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1nr.78/17, me dt. 06.03.2017

Procesmbajtësi

Kryetari i kolegjit

Hysni Ismaili

Shqipe Qerimi

Anëtarët e kolegjit:

1. Rasim Rasimi

2. Gani Zabeli

